




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 184/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi – Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.P.T. "Pashtriku" - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE N.T. "El-Shpëtimi"- Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material higjenik për institucionet Arsimore", me numër të prokurimit: 616-19-015-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më datën 15.05.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.P.T. "Pashtriku" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material higjenik për institucionet Arsimore", me numër të prokurimit: 616-19-015-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Furnizim me material higjenik për institucionet Arsimore", me numër të prokurimit: 616-19-015-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.P.T.”Pashtriku” - Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 01.03.2019.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 27.03.2019.

Njoftimi me letër standarde për tenderues të eliminuar është bërë me dt: 08.04.2019.

Kërkesa për rishqyrtim është bërë me dt: 15.04.2019.

Autoriteti Kontraktues me datën: 16.04.2019, ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues N.P.T.”Pashtriku” - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 24.04.2019, me nr. 184/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE N.T. “El-Shpëtimi”- Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material higjenik për institucionet Arsimore”, me numër të prokurimit: 616-19-015-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 37 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 39, 41 dhe 56 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 02.05.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 08.05.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim: Autoriteti Kontraktues –Komuna Prishtinë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është

furnizim me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore të parashtruesit të ankesës kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit: *“Nuk e përmbushni kriterin e përcaktuar në vlerë prej 50 000.00€, për projekte të realizuara dhe forma e sigurimit të tenderit nuk është dorëzuar në formën e kërkuar si dhe nuk i plotëson kushtet në përputhje me nenin 39 RrUOPP”*.

Kundër të njëjtit arsyetim parashtruesi i ankesës në afatin e paraparë me ligj, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues, me pretendimet e njëjta ankimore si në ankesën e deponuar në OSHP, përderisa AK/ Komuna Prishtinë, përmes vendimit refuzon kërkesën si të pa bazuar me arsyetimin e njëjtë si në letër standarde.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të ofertës së parashtruesit të ankesës, rezulton që i njëjti ka prezantuar listën e projekteve të realizuara, me gjithsej 5 pozicione të përshkruara përmes të cilave ka prezantuar dëshmi dokumentare dhe sipas tyre mbulohet vlera e kërkesës së autoritetit kontraktues.

Po ashtu edhe kundrejt pikës dy (2), të arsyetimit të eliminimit parashtruesi i ankesës ka prezantuar dëshmi / polisën e sigurimit të tenderit me nr. 060010250062513, të datës 26.03.2019, për këtë aktivitet të prokurimit. Përderisa pjesën e aneksit 4, të dosjes së tenderit e ka bashkangjitur me ankesë, e cila e përmban datën e njëjtë. Për më tepër neni 29, par 13, i RrUOPP-së, shprehimisht potencon se, në rast të dorëzimit të ofertës përmes platformës elektronike, siguri i tenderit duhet të dorëzohet i skanuar së bashku me ofertë, ndërsa forma origjinale e sigurimit të tenderit do të kërkohej nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE NPT “Pashtriku” – Prishtinë, të aprovohej si e bazuar, të anulohet propozimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në afatin ligjor operatori ekonomik ankues dhe Autoriteti Kontraktues, nuk ka kthyer përgjigjeje se a pajtohen apo nuk pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.05.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, eksperti shqyrtues u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet

nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtrirat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Gashi deklaroj: Lidhur me këtë lende të gjitha gjerat i kemi cek edhe AK-se e cila e ka kthyer negativisht po të njëjtat janë të dorëzuara edhe në ankesën e OSHP-së. Pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues. AK ka dështuar sepse nuk e ka kërkuar një vërtetim të sigurisë së tenderit i cili është i mjaftuar që është lëshuar një polisë e sigurimit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Sallahu deklaroj: Ne si AK mbështesim fuqimisht vendimin për refuzim të OE ankues, për shkak që OE ankues nuk ka dorëzuar ashtu siç duhet, oferta është dorëzuar jo e plotë ndërsa i ka munguar pjesa e dytë dhe është i pavlefshëm.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti shqyrtues z. Bibaj deklaroj: Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër eliminimit të ankuesit ku si arsye kanë qenë dy (2), arsye si pretendim kryesor ka të bëjë me sigurimin e tenderit të parashtruesit të ankesës është e vërtetë që parashtruesi i ankese përmes ofertës ka prezantuar polisen e sigurimit ku të dhënat e përshkruara lidhen me këtë Aktivitet Prokurimi megjithatë OE në ankese ka prezantuar edhe formën e standardit të DT e cila i përmban kushtet dhe pikat e kërkuara me LPP-ë, të dy shkresat e përmbajnë datën 26.03.2019 pra janë sjell para hapjes së ofertave arsyen për rivlerësim të ofertave e kemi mbështet në neni 29 paragrafi 13 të RrUOPP-së, ku i njëjti paragraf sqaron kure ofertuesit ofertojnë përmes e-prokurimit në ofertë prezantojnë sigurimin e tenderit ndërsa forma origjinale e sigurimit të tenderit do të kërkohej nga tenderuesi të cilit AK ka për qëllim ta shpërblejë për kontratë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Gashi deklaroj: Propozojmë që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Sallahu deklaroj: Kërkojmë që ankesa e OE të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-se.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi, gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues pretendon se është eliminuar pa të drejtë nga ana e autoritetit kontraktues me arsyetimin

se “Nuk e përmbushni kriterin e përcaktuar në vlerë prej 50 000.00€, për projekte të realizuara dhe forma e sigurimit të tenderit nuk është dorëzuar në formën e kërkuar si dhe nuk i plotëson kushtet në përputhje me nenin 39 RrUOPP” ndërsa kundër të njëjtit arsyetim OE ankues në afatin e paraparë me ligj, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues, me pretendimet e njëjta ankimore, përderisa AK/ Komuna Prishtinë, përmes vendimit refuzon kërkesën si të pa bazuar me arsyetimin e njëjtë si në letër standarde.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion konstaton se autoritetit kontraktues me të drejtë ka eliminuar OE ankues pas që i njëjti tek 9.1 *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale*. Ku operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit duhet që ta plotësonin këtë kërkesë në të cilën thuhet: *OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat të ngjashme, për furnizim me materiale higjienike në vlerë minimale prej 50.000,00 €, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë)*. Andaj, paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion konstaton se OE ankues N.P.T.”Pashtriku” – Prishtinë, në dëshmitë të cilat i ka ofruar rezulton se nuk i ka përmbushur kriterin e përcaktuar si më lartë nga ana e autoritetit kontraktues Komuna Prishtinë, pasi që në listën e projekteve të realizuara po nga ky OE rezulton se nuk mund ta mbulojë vlerën e kërkesës së autoritetit kontraktues në shumë prej 50.000,00 €.

Sa i përket pretendimit të OE ankues N.P.T.”Pashtriku” – Prishtinë, se është eliminuar nga AK se nuk ka të bashkangjitur ANEKSIN 4 të dosjes së tenderit sigurimin e tenderit. Paneli shqyrtues konstaton se OE ankues i çekur si më lart Aneksi 4 nuk ka dorëzuar në përputhje me kërkesat e parashtruara në DT, nuk e ka dorëzuar /ngarkuar pjesë e dytë sigurinë e tenderit Garancion me kërkesë të parë, përshkrimi i cili bëhet në këtë dokument.

Andaj me të drejtë autoriteti kontraktues ka eliminuar operatorin ekonomik në fjalë sepse siguri i tenderit i dorëzuar nga ky operator ekonomik në platformën elektornike nuk është dorëzuar në formën e kërkuar nga autoriteti kontraktues Komuna Prishtinë, dhe si i tillë nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktues për dorëzimin e sigurimit të tenderit sipas ANEKSIN 4.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit si dhe sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues/teknik, vlerëson se autoriteti kontraktues ka vepruar në pajtim me nenin 59 dhe 60 të LPP-së, për faktin se ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me çmim më të lirë nga të gjithë ofertuesit e përgjegjshëm.

Po ashtu autoritetet kontraktuese ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna Prishtinë, – Prishtinë,
- 1x1 OE- N.P.T."Pashtriku" - Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi

